

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Kolegji për të mitur i përbërë nga gjyqtaret Hashim Çollaku kryetar, Rasim Rasimi dhe Biljana Rexhiq anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Leonita Lajçi, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarve E.P. nga Prizreni për shkak të veprës penale ndihmë në trafikim me njerëz nga neni 171 par.2 lidhur me par.1 dhe 31të KPRK-së, E.D. për shkak të veprës penale trafikim me njerëz nga neni 171 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe veprës penale mundësim i prostitucionit nga neni 241 par.1 të KPRK-së, A.I. për shkak të veprës penale trafikim me njerëz nga neni 171 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe P.L. për shkak të veprës penale mundësimi i prostitucionit nga neni 241 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtëses së të akuzuarës A.I. av. S.K. dhe ankesës së mbrojtësit të akuzuarës E.D. av. V.Rr., të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PM.nr.82/2015, të datës 02.03.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 15.11.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

1. **Refuzohen** si të pabazuara ankesat e mbrojtësve së të akuzuarve A.I. dhe E.D., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, PM.nr.82/2015, të datës 02.03.2017, **vërtetohet**.
2. Në pjesën tjetër aktgjykimi ka ngel i pashqyrtuar.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktgjykimin PM.nr.82/2015, të datës 02.03.2017, të akuzuarin E.P. e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale ndihmë në trafikim me njerëz nga neni 171 par.2 lidhur me par.1 dhe 31të KPRK-së, të akuzuarën E.D. për shkak të veprës penale trafikimi me njerëz nga neni 171 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe veprës penale mundësimi i prostitucionit nga neni 241 par.1 të KPRK-së, të akuzuarën A.I. për shkak të veprës penale trafikim me njerëz nga neni 171 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe të akuzuarën P.L. për shkak të veprës penale mundësimi i prostitucionit nga neni 241 par.1 të KPRK-së, të akuzuarin E.P. e ka gjykuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 5 (pesë) muaj dhe dënim me gjobë në shumën prej 300 (treqind) euro. Në dënimin e shqiptuar do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 22.08.2013 e deri më datën 28.01.2015 .Të akuzuarës E.D. i ka shqiptuar për veprën penale si në pikën **II** të dispozitivit të aktakuzës me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti dhe dënim me gjobë në shumën prej 200€, për

veprën penale si në pikën **III** të dispozitivit të aktakuzës me dënim me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti dhe dënim me gjobë në shumën prej 200€. Gjykata konform nenit 80 të KPRK-së, të akuzuarës E.D.i i ka shqiptuar dënim unik me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muaj dhe dënim me gjobë në shumën prej 300€, në dënimin e shqiptuar do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 22.08.2013 deri me dt.14.07.2014.

Të akuzuarën A.I., e ka gjykuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti dhe dënim me gjobë në shumën prej 200 €, në dënimin e shqiptuar do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 22.08.2013 e deri me dt.14.07.2014.

Të akuzuarën P.L. e ka gjykuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti dhe dënim me gjobë në shumë prej 200 euro. Në dënimin e shqiptuar do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 22.08.2013 e deri me 14.07.2014

Nëse të akuzuarit dënimin me gjobë nuk e paguajnë brenda afatit të paraparë ligjor, i njëjti do ti zëvendësohet në dënim me burgim, ashtu që për çdo 20€ do ti llogaritet 1 (një) ditë me burg.

Të akuzuarit gjykata i ka obliguar që ti kompensojnë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare në pjesë të barabarta, kurse në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë secili veç e veç nga 50€, në afat prej 15 ditësh, nga dita kur aktgjykimi të merr formë të prerë.

E dëmtuara e mitur E.M. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor ankesë kanë ushtruar:

Mbrojtësja e të akuzuarës A.I. av. S.K. për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarës ti shqiptoj një dënim më të ulët.

Mbrojtësi i të akuzuarës E.D. av. V.Rr. për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarës ti shqiptoj një dënim më të ulët.

Prokurori i Apelit me parashtresën PPAM/I nr.83/2017, të dt.21.09.2017, ka propozuar që të refuzohen si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të të akuzuarave, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit në pajtim me nenin 390 të KPP-së, caktoi seancën e kolegjit për të cilën seancë u njoftuan Prokurori i Apelit, të akuzuarit, e dëmtuara e mitur me përfaqësuesin ligjor dhe mbrojtësit e të akuzuarve. Në seancën e kolegjit prezantoi, vetëm e akuzara A.I. dhe mbrojtësja e saj av. S.K., kurse palët e tjera edhe pse të njoftuara me rregull nuk morën pjesë në seancën e kolegjit. Mbrojtësja e të akuzuarës A.I. av. S.K. në seancë deklaroi se mbetet pranë pretendimeve të parashtruara me shkrim,

duke propozuar që të akuzuarës ti shqiptohet një dënim më i butë. E akuzuara A.I. në seancën e kolegjit deklaroi se e përkrah fjalën e mbrojtëses së saj.

Gjykata e Apelit pasi që i shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale, studioi aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë gjeti se :

Ankesat nuk janë të bazuara.

Nga shkresat e lëndës rezulton se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin edhe sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi dhe në këtë aspekt konform dispozitës së nenit 394 të KPP dhe gjeti se aktgjykimi i shkallës së parë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij dhe as shkelje të Ligjit penal në dëm të të akuzuarve.

Po ashtu, as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, ngase siç rezulton nga shkresat e lëndës të akuzuarat e kanë pranuar fajësinë, prandaj, sipas nenit 383 par 2 të KPP, ndaj aktgjykimin që është marr në bazë të pranimit të fajësisë, ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve.

Në ankesën e mbrojtëses së të akuzuarës A.I. av. S.K. sa i përket vendimit për sanksionin penal theksohet se gjykata e shkallës së parë me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit nuk i ka vlerësuar në mënyrë të drejtë rrethanat lidhur me këtë veprë penale, posaçërisht nuk e ka vlerësuar sinqeritetin dhe bashkëpunimin dhe pendimin e të akuzuarës, dhe se edhe me një dënim më të butë do të arrihet qëllimi i dënimit.

Në ankesën e mbrojtësit të akuzuarës E.D. av. V.Rr. sa i përket vendimit për sanksionin penal theksohet se dënimi i shqiptuar të akuzuarës është i pa drejtë dhe i paqëndrueshëm, kurse dënimi është shumë i lartë dhe jo i bazuar sa duhet në ligj dhe në kundërshtim me të drejtën materiale.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, pretendimet e mbrojtësve të akuzuarave për një dënim më të butë janë të pabazuara. Gjykata e shkallës së parë drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit siç parashihet në dispozitën e nenit 73 të KPK-së. Kështu, si rrethana lehtësuese për të akuzuarat mori për bazë pranimin e fajësisë, se kishin sjellje korrekte në gjykatë, dhe se më parë nuk kanë qenë të dënuara.

Gjykata e Apelit vlerëson se pranimi i fajësisë së të akuzuarave për veprën e kryer dhe pendimi në raport me peshën e veprës së kryer, nuk e arsyeton pretendimin e mbrojtësve të tyre për shqiptimin e një dënimi më të butë ngase në ankesën e mbrojtësve të akuzuarave nuk ceket ndonjë rrethanë e re lehtësuese e cila nuk ka qenë objekt vlerësimi nga gjykata e shkallës së parë e cila do të ndikonte në shqiptimin e ndonjë dënimi më të butë. Kjo Gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarave nga ana e gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarave si ekzekutore dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i parashikuar me

dispozitën e nenit 41 të KPRK-së , ku do të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e sa, të parandalojë personat tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Meqenëse ndaj aktgjykimit nuk ka pasur ankesë përkitazi me të akuzuarit E.P. dhe Pranvera Lahi, aktgjykimi në këtë pjesë ka ngelur i pashqyrtuar.

Nga kjo që u tha më lartë e në bazë të nenit 401 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.440/2017, me dt. 15.11.2017.

Procesmbajtës

Anëtarët e kolegjit

Kryetari i kolegjit

Leonita Lajçi

Rasim Rasimi

Hashim Çollaku

Biljana Rexhiq